

HASI ENERGJI SHPK

**Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017**

HASI ENERGJI SHPK
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

Nr	A K T I V E T	Shen	2017	2016
	AKTIVET AFATSHKURTRA			
	▶ Aktivet monetare	3	585,874	929,600
1	Banka		584,785	929,535
2	Arka		1,089	65
	▶ Investime		0	0
1	Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit			
2	Aksionet e veta			
3	Të tjera financiare			
	▶ Të drejta të arkëtueshme	4	423,459	397,344
1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit			
2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit			
3	Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
4	Të tjera		423,459	397,344
5	Kapital i nënshkruar i papaguar			
	▶ Inventarët		0	0
1	Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme			
2	Prodhime në proces dhe gjysmëprodukte			
3	Produkte të gatshme			
4	Mallra			
5	Aktive biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)			
6	AAGJM të mbajtura për shitje			
7	Parapagime për inventar			
	▶ Shpenzime të shtyra			
	▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
I	TOTALI AKTIVEVE AFASHKURTRA		1,009,333	1,326,944
	AKTIVET AFATGJATA		0	0
	▶ Aktivet financiare		0	0
1	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit			
2	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike Brenda grupit			
3	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
4	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrjeje			
5	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata			
6	Tituj të tjerë të huadhënies			
	▶ Aktivet materiale		0	0
1	Toka dhe ndërtesa			
2	Impiante dhe makineri			
3	Të tjera instalime dhe pajisje			
4	Parapagime për aktive materiale dhe në proces			
	▶ Aktive biologjike		0	0
	▶ Aktive jo materiale		0	0
1	Koncesione, patenta, liçenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme			
2	Emri i Mirë			
3	Parapagime për AAJM			
	▶ Aktive tatimore të shtyra		0	0
	▶ Kapital i nënshkruar i papaguar		0	0
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		0	0
	AKTIVE TOTALE		1,009,333	1,326,944

Arbes Rusi



REZARTA KOÇOLLARI
EKSPERTI KONTABEL
NIPIT: 1111111111
NIPIT: 1111111111

HASI ENERGJI SHPK
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shen	2017	2016
	► Detyrime afatshkurtra:	5	55,356	18,786
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>			
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>			
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>			
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		15,954	16,228
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>			
6	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>			
7	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
8	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		38,121	748
9	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		1,281	1,810
10	<i>Të tjera të pagueshme</i>			
	► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		0	0
	► Të ardhura të shtyra		0	0
	► Provizione		0	0
I	Totali i Detyrimeve afatshkurtra		55,356	18,786
	► Detyrime afatgjata		0	0
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>			
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>			
3	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>			
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>			
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>			
6	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>			
7	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
8	<i>Të tjera të pagueshme</i>			
	► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		0	0
	► Të ardhura të shtyra		0	0
	► Provizione		0	0
	1 <i>Provizione për pensionet</i>			
	2 <i>Provizione të tjera</i>			
	► Detyrime tatimore të shtyra		0	0
II	Totali i Detyrimeve afatgjata		0	0
	DETYRIMET TOTALE		55,356	18,786
	► Kapitali dhe Rezervat			
	► Kapitali i Nënshkruar		4,600,000	4,600,000
	► Primi i lidhur me kapitalin			
	► Rezerva rivlerësimi			
	► Rezerva të tjera		93,408	93,408
	1 <i>Rezerva ligjore</i>		93,408	93,408
	2 <i>Rezerva statutore</i>			
	3 <i>Rezerva të tjera</i>			
	► Fitimi i pashpërndarë		(3,385,250)	(2,258,062)
	► Fitim / Humbja e Vitit		(354,181)	(1,127,189)
	Totali i Kapitalit		953,977	1,308,158
III	TOTALI I DEYRIMEVE DHE KAPITALIT		1,009,333	1,326,944

HASI ENERGJI SHPK
PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shen	2017	2016
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit			
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces			
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar			
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		0	0
	1 <i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>			
	2 <i>Të tjera shpenzime</i>			
▶	Shpenzime të personelit		(67,775)	(8,976)
	1 <i>Paga dhe shpërblime</i>		(55,129)	(4,488)
	2 <i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)</i>		(12,646)	(4,488)
▶	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi			
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi		(285,622)	(1,099,136)
▶	Të ardhura të tjera		0	0
	1 <i>Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
	2 <i>Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
	3 <i>Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
▶	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra			
▶	Shpenzime financiare		(784)	(19,077)
	1 <i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
	2 <i>Shpenzime të tjera financiare</i>		(784)	(19,077)
▶	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
▶	Humbja para tatimit		(354,181)	(1,127,189)
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			0
	1 <i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>			
	2 <i>Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë</i>			
	3 <i>Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve</i>			
▶	Humbja e vitit		(354,181)	(1,127,189)
▶	Humbja për:			
	1 <i>Pronarët e njësisë ekonomike mëmë</i>			
	2 <i>Interesat jo-kontrolluese</i>			

HASI ENERGJI SHPK
PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2017	2016
▶	Humbja e vitit	(354,181)	(1,127,189)
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		
▶	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	0	0
▶	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	(354,181)	(1,127,189)
▶	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:		
	<i>Pronarët e njësisë ekonomike mëmë</i>		
	<i>Interesat jo-kontrolluese</i>		

HASI ENERGJI SHPK
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

Nr	Pasqyra e fluksit monetar - Metoda Indirekte	2017	2016
▶	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
	Humbja e vitit	(354,181)	(1,127,189)
	Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
	Shpenzimet financiare jomonetare		
	Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
	Shpenzime konsumi dhe amortizimi		
	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
	Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
	Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
	Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
	Rritje në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(26,115)	(49,534)
	Rënie/(rritje) në inventarë		
	Rritje në detyrimet e pagueshme	36,570	17,125
	Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(343,726)	(1,159,597)
▶	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
	Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		
	Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
	Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		
	Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
	Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
	Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
	Dividentë të arkëtuara		
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	0	0
	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
	Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		
	Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
	Hua të arkëtuara		
	Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë		
	Riblerje e aksioneve të veta		
	Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
	Pagesa e huave		
	Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
	Interes i paguar		
	Dividendë të paguar		
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	0	0
	Rënie neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(343,726)	(1,159,597)
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar 2017	929,600	2,089,198
	Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2017	585,874	929,600

HASI ENERGJI SHPK
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
▲ Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	4,600,000	0	0	93,408	0	0	(2,258,062)	(1,127,189)	0	0	1,308,157
▲ Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017	4,600,000	0	0	93,408	0	0	(2,258,062)	(1,127,189)	0	0	1,308,157
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											0
Transferimi i rezultatit të vitit							(1,127,189)	1,127,189			0
Humbja e vitit								(354,181)			(354,181)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											0
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											0
Emetimi i kapitalit të nënshkruar											0
Dividendë të paguar											0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											0
▲ Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	4,600,000	0	0	93,408	0	0	(3,385,251)	(354,181)	0	0	953,977

Shënimet shoqëruese në faqet 07- 14 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

HASI ENERGJI SHPK
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

“HASI ENERGJI” shpk (Shoqëria) është një shoqëri Shqiptare me aksioner kompanine ENSO HYDRO ENERGJI në datën 31 Dhjetor 2017. Shoqëria është krijuar më 03/03/2006 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 21/03/2006 me numrin e identifikimit K43522625F. Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Rrugen Jul Variboba, Vila 10, Tirane.

Përfaqësuesja ligjore e shoqërisë në 31.12.2017 është Znj. Arbes Rusi.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është që të zotërojë aksione në shoqëri të tjera që operojnë në biznesin e ndërtimit dhe operimit të impianteve hidro energjitike për prodhimin e energjisë si dhe të ushtroje veprimtarinë e saj në biznesin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë.

Veç kësaj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që rezulton ose që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë me objektivin e mesiperm. Për të arritur qëllimin e mesiperm, shoqëria mund të kryejë çdo transaksion si: tregtar, financiar, qiraje ose veprim hipotekues, i cili mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për të ndjekur objektivin e shoqërisë.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

a) Të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të bazuara në parimet e kontabilitetit dhe raportimit financiar të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përkrahën në Ligjin Nr. 9228 datë 29 prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Aktivitet afatshkurtra

Mjetet Monetare përfshijnë mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj në vlerën neto.

Investime përfshijnë Letra me vlerë të njëjësive ekonomike brenda grupit (aksione) të paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, riblerjen e aksioneve të emetuara më parë nga vetë shoqëria aksionare të paraqitura me shumën e paguar për t'i riblerë dhe letra me vlerë të njëjësive të tjera ekonomike dhe investime të tjera financiare të mbajtura për tregtim (aksione, obligacione, zotërime në fonde investimesh, etj të paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Të drejta të arkëtueshme përfshijnë kërkesa të arkëtueshme afatshkurtra (klientë), kërkesat e arkëtueshme nga njësi të tjera të grupit, kërkesat e arkëtueshme nga njësi ekonomike mbi të cilat ushtrohet një ndikim i ndjeshëm apo ku ka investime të tjera financiare, kërkesa të arkëtueshme nga palë të tjera të lidhura (debitorë të tjerë të tjere) të paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe llogari/kërkesa të arkëtueshme afatgjata për kapitalin aksionar të autorizuar e të emtuar, por të papaguara. Ato duhet të paraqiten me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Inventarët

Inventarët e njëjësive prodhuese përbëhen nga lëndët e para dhe materialet për konsum, puna në proces dhe produktet e përfunduara gati për shitje, mallrat e blera dhe të mbajtura për rishitje me pak ose aspak nevojë për ndryshim, që janë inventarë tipike për njësitë tregtare si dhe aktive biologjike të vlerësuar sipas modelit të koston ose modelit të Vlerës së Drejtë.

Inventarët maten fillimisht me kosto.

HASI ENERGJI SHPK
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Pas njohjes, një njësi ekonomike duhet të matë inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur. Inventaret duhet t'i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Kërkesa për vlerësimin e inventarit me vlerën më të ulët mes koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t,u përfunduar dhe shitur e detyron njësinë ekonomike që të regjistrojë në kontabilitet humbjet nga zhvlerësimi në momentin kur ky i fundit ndodh. Zvogëlimet për të arritur në çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t u përfunduar dhe shitur mund të ndodhin në ato raste kur ka një rënie të çmimeve të shitjes ose kur shpenzimet e përfundimit apo shpenzimet direkte të shitjeve janë rritur. Ka dhe raste kur disa produkte dëmtohen përpara se të shiten ose kur disa të tjerë mund të mbahen në sasira të tilla që nuk mund të shiten brenda një periudhë kohe të arsyeshme. Në raste të tilla, kostoja e inventarit duhet të zvogëlohet për të arritur në çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t,u përfunduar dhe shitur. Metoda e vlerësimit është hyrje e pare – dalje e pare (FIFO).

Shpenzime të shtyra paraqesin teprricat e llogarive që evidentojnë gjendjen dhe ndryshimet në shumën e parapagimeve ndaj të treta për shërbime, punime apo për shpenzime të tjera të paguara në avance, por jo të konstatuara për periudhën ushtrimore. Metoda e vlerësimit të tyre është me vlerë nominale të shumës së parapaguar.

Aktivitet afatgjatë

Aktive financiare përfshijnë tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit, tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupi, tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjatë letrat me vlerë (aksionet, bono të thesarit, obligacione, zotërime në fonde investimesh, etj) që nuk mund të realizohen brenda 12 muajve të ardhshëm të paraqitura me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm

Aktivitet Afatgjatë Materiale

Në bilanc AAM përfshijne Toka dhe ndërtesa, impiante dhe makineri, të tjera Instalime dhe pajisje që paraqiten me koston minus amortizimin minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe parapagime për aktive materiale dhe në proces që paraqiten me vlerë nominale e shumës së parapaguar.

Aktivitet Afatgjatë Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe koston e tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit për ndërtesat dhe instalimet teknike është metoda lineare e cila merr në konsideratë jetën e dobishme ekonomike, ndërsa amortizimi për AAM të tjera llogaritet mbi bazën e zbritese.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabel. Keto përfshihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Aktivitet afatgjatë jomateriale (AAJM) janë aktive të identifikueshme jomonetare pa përmbajtje fizike, të mbajtura për qëllim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t'ua dhënë me qira të treta ose për qëllime administrative. Ato paraqiten me koston minus amortizimin e akumuluar minus ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Detyrime afatshkurtra përfshijnë titujt e huamarrjes, detyrime ndaj institucioneve të kredisë, të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit, dëftesa të pagueshme, të pagueshme ndaj njërive ekonomike brenda grupit, të pagueshme ndaj njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse të paraqitura me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe arkëtime në avancë për porosi të paraqitura me vlerën nominale të shumës së arkëtuar në avancë. Detyrimet të pagueshme ndaj

HASI ENERGJI SHPK
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore, të pagueshme për detyrimet tatimore paraqiten me vleren nominale të shumava për t'u paguar.

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara përfshijne detyrimet e llogaritura për shpenzimet e konstatuara sipas kontrates, por të pagueshme në një periudhë të mevonshme. Ato paraqiten me vleren nominale të shumava për t'u paguar.

Të ardhura të shtyra përfshijne shuma të marra në avancë, për të ardhurat e paperfituara ekonomiksht të cilat njesia ekonomike do t'i njohe si të ardhura të periudhës duke i shperndare në periudhat e ardhme, në përpjestim me kryerjen e shërbimeve ose punimeve. Këtu përfshihen edhe grandet e marra nga njesia ekonomike dhe paraqiten me kosto të amortizuar.

Provizione paraqesin detyrim aktual për të cilin shuma apo koha e shlyerjes është e pasigurtë. Vlerësimi i shumës së mundshme të nevojshme për shlyerjen e detyrimit bëhet nga drejtuesit e njësisë.

Zerat e detyrimeve afatgjata, që mund të realizohen pas 12 muajve, (detyrime afatgjata, të pagueshme për shpenzime të konstatuara, të ardhura të shtyra, provizione) janë të njëjta me ato të detyrimeve afatshkurtra me përjashtim të detyrimeve tatimore të shtyra.

Detyrime tatimore të shtyra

Detyrime tatimore të shtyra janë shumat e tatimit mbi fitimin, të pagueshme në periudha të ardhshme, të cilat krijohen për shkak të diferencave të përkohshme të tatueshme

Kapitali i Vet është diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve të njesise ekonomike me datën e pasqyres së pozicionit financiar.

Kapitali i Nënshkruar paraqitet kapitalin e kontribuar nga aksioneret ose ortakët.

Primi i lidhur me kapitalin paraqet arkëtimet të bera gjatë emetimit të aksioneve ose kapitalit me një vlerë të emetimit mbi ose nën vlerën nominale të tyre.

Rezerva rivlerësimi përfshijne të ardhurat dhe shpenzimet e përealizuara që në përputhje me SKK-të nuk regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (për shembull, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale (SKK 5) rezerva që rrjedhin nga diferencat e kursit të këmbimit në rastin e konsolidimit të njësisë të huaja të kontrolluara në përputhje me SKK 9, etj. Rezerva të tjera përfshijne Rezerva ligjore, Rezerva statutore

Fitimi i pashpërndarë paraqesin Fitim/humbjen e akumuluar nga periudhat kontabël të mëparshme që as nuk është paguar si dividend dhe as nuk është përdorur për ndonjë qëllim tjetër nga njesia ekonomike (për shembull për zmadhimin e kapitalit aksionar ose rezervave).

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njesia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar

HASI ENERGJI SHPK
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (ndonjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).

Shpenzimet

Shpenzimet janë flukse dalëse (pakësimet e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese që rezultojnë në pakësimin e aktiveve apo rritjen e detyrimeve dhe që zvogëlojnë kapitalin e njësisë ekonomike, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me shpërndarjet të pjesëmarrësit të kapitalit. Njohja e shpenzimeve rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve. Një njësi ekonomike duhet të njohë shpenzimet në pasqyrën e performancës financiare kur lind një ulje në përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhet me një pakësim të një aktivi ose rritje të një detyrimi, e cila mund të matet me besueshmëri.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përmblodhin të ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara në banka, fitimet nga shitja e aktiveve financiare të mbajtura për shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet për interesat nga huatë, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet e aktiveve financiare. Gjithë kostot e huamarrjeve njihen në humbje fitime mbi bazën e përdorimit të metodës së interesit efektiv.

Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet që lidhen me tatimin mbi të ardhurat paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur ai lidhet me zërat e kapitalit dhe në këto rast paraqiten direkt në kapital.

Shpenzimi tatimor aktual është shuma e tatimit që pritet të paguhet bazuar në të ardhurat e vitit ushtrimor, shkallën tatimore që zbatohet në ditën e raportimit si dhe çdo korrigjim të detyrimeve tatimore të viteve paraardhëse. Tatimi i shtyre njihet duke përdorur metodën e pasivitetit të bilancit, duke marrë si diferencë të perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar në shkallën tatimore, të percaktuar nga ligjet që janë në fuqi, që pritet të jete e zbatueshme në momentin kur diferencat e perkohshme do të zhduket.

Kompania njihet aktivin për tatim të shtyrë vetëm për atë që është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktiviteti tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për atë që nuk ka më mundësi që fitimi i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

Transaksionet me monedhat e huaja

Monedha e përdorur dhe raportuese

Zërat e përfshirë në pasqyrën financiare të kompanisë maten në monedhën bazë të mjedisit ekonomik në të cilën njësia ekonomike vepron (monedha e përdorur). Pasqyrat financiare raportohen në LEKE shqiptar (ALL), e cila është monedha e përdorur dhe raportuese e kompanisë.

Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet në monedhë të huaja konvertohen në monedhën e përdorur duke përdorur kursin e kembimit në datën e kryerjes së transaksionit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaja dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve në monedhë të huaja me kursin e kembimit të fundvitit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursin e kembimit me të rendesishme janë :

HASI ENERGJI SHPK
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
1 EUR	132.95	135.23
1 USD	111.11	128.17

3. AKTIVE MONETARE

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Arka		
Në LEK	1,089	38
Në EUR	0	27
Totali Arka	1,089	65
Banka		
Në LEK	124,962	914,472
Në EUR	459,823	15,063
Totali Banka	584,785	929,535
Totali	585,874	929,600

4. TË DREJTA TË ARKËTUESHME

Zëri të drejta të arkëtueshme përbëhet nga të tjera të arkëtueshme si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
TVSH e kreditueshme	164,227	132,098
Parapagime per furnitore	0	6,014
Parapagim tatim fitimi	259,232	259,232
Totali	423,459	397,344

5. DETYRIME AFATSHKURTRA

Zëri detyrime afatshkurtra përbëhet nga detajimi si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Detyrime per pagat e punonjesve	28,914	0
Furnitore te ndryshem	15,954	16,228
Detyrime per Sigurimet shendetesore	9,207	748
Detyrime tatimore per Tatimin ne Burim (qira)	891	1,810
Detyrime per Tatimin mbi te Ardhurat Personale	390	0
Totali	55,356	18,786

HASI ENERGJI SHPK
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

10. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin është i pagueshem ne normen 15% bazuar mbi fitimin neto per periudhen dhe korrigjuar per efekte tatimore ne perputhje me legjislacionin Shqiptar tatimor:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Humbja para tatimit	(354,181)	(1,127,189)
Shtuar: Shpenzime te panjohura		
Shpenzime pa dokumentacion mbeshtetes sipas formatit te aprovuar nga autoritetet fiskale	1,506	683,987
Humbja fiskale	(352,675)	(443,202)
<i>Tatim fitimi i llogaritur 15%</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
Tatim fitimi i parapaguar gjate vitit	0	0
Tatim fitimi per t'u (arketuar)/paguar	0	0

Në kategorinë “Shpenzime pa dokumentacion mbështetës sipas formatit të aprovuar nga autoritetet fiskale” përfshihen të gjithë ato shpenzime të pambështetura në dokumente që nuk janë në standartet e aprovuara nga autoritetet tatimore. Këto lloj shpenzimesh janë efektivisht kosto, por të pazbritshme për qëllime tatimore.

11. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve, ose detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse vendoset apo jo një çmim. Një palë e lidhur është një palë, e cila kontrollon, kontrollohet, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë tregtare; ka një interes mbi njësinë që i jep një influencë të rëndësishme mbi entitetin; ose ka një kontroll të lidhur mbi entitetin; është ortak në shoqëri; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën entiteti është sipërmarrës; ose është një anëtar i personelit drejtues të entitetit, ose mëmës së tij (duke përfshirë familjarët e afërm të çdonjërit prej individëve të sipërpërmendur).

Në 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 nuk ka balanca të transaksioneve me palët e lidhura.

12. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk kanë ndodhur ngjarje pas datës së bilancit të cilat mund të kërkojnë paraqitje, apo rregullim në pasqyrat financiare.

13. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

Shoqëria nuk ka angazhime dhe detyrime të mundshme që kërkojnë paraqitje në pasqyrat financiare.

HASI ENERGJI SHPK
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017 DHE 31 DHJETOR 2016

14. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

a) Risku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e instrumentave financiare do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe nga rreziku që maturimi i aktiveve që mbartin interes ndryshon nga maturimi i detyrimeve që mbartin interes, të përdorura për të financuar këto aktive. Periudha e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar mbi një instrument financiar, tregon se cili do të jetë ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të normës së interesit. Shoqëria nuk ka aktive financiare që mbartin interes në fund të vitit 2017 dhe 2016.

b) Risku i kreditit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit nëpërmjet aktiveve të saj financiare (llogaritë rrjedhëse), parapagimeve dhe llogarive të arkëtueshme. Shoqëria manaxhon rregullisht ekspozimin e saj ndaj rrezikut duke monitoruar nga afër ekspozimin ndaj palëve të treta për parapagimet dhe për llogaritë e arkëtueshme. Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 shoqëria nuk është shumë e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit.

c) Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Vlerat e mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare në pasqyrat financiare përafrojnë vlerën e tyre të drejtë.

d) Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit pasi transaksionet ndodhin në të dyja monedhat, si ajo vendase dhe ajo e huaj. Manaxhimi monitoron dhe vendos limitin për ekspozimin e lejuar për çdo monedhë dhe në total. Shoqëria nuk angazhohet në kryerjen e veprimeve, apo tregtimin e instrumentave derivative. Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 shoqëria nuk është shumë e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

e) Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku nga mospërputhja e maturiteteve të aktiveve dhe detyrimeve. Shoqëria monitoron likuiditetin mbi baza periodike në mënyrë që të manaxhojë detyrimet kur ato lindin.